

AKT THEMELIMI
i Shoqërisë "4E Construction" Sh.p.k.

Sot, me datë 05/02/2025,

-Zj.Eriona **Komino**, shtetase shqiptare, lindur më 25.10.1978, në Tiranë, mbajtëse e dokumentit të identifikimit me nr. personal H86025041E, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar

dhe

-Z.Erion **Komino**, shtetas shqiptar, lindur më 07.03.1977, në Këlcyre, mbajtës i dokumentit të identifikimit me nr. personal H70307065C, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me Ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare" (I ndryshuar) dhe Ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, " Për regjistrimin e biznesit ", miratojnë këtë statut si vijon:

NENI 1
EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "**4E Construction**" Sh.p.k..

NENI 2
SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga e Vilave, Kompleksi Sunrise Residence, Z4G2, Ap.2, Lundër, Tiranë.

Shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërië, si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përvec zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas Vendimit të Asamblesë së Ortakëve.

NENI 4
OBJEKTI

Shoqëria ka për objekt të veprimtarisë:

Ndërtimi i godinave civile, industriale, shkollave, spitaleve, godinave me destinacion social-kulturor, urbane dhe rurale, shumëkatëshe, etj.

Punime të shtrimit të rrugëve, të veprave të artit, të instalimeve elektrike dhe hidraulike në to,etj.

Eriona Komino




Projektimin e objekteve dhe godinave të ndryshme industriale dhe civile, shkollave spitaleve, godinave me destinacion social kulturor, urbane dhe rurale, shumëkatëshe, veprat e artit, etj.

Prodhim i materialeve të ndërtimit, përmes ngritjes së nyjeve përkatëse, nyjeve të betonit, lavazheve, etj. Tregtimin me shumicë dhe pakicë i mallrave në përgjithësi dhe të ndërtimit në veçanti, importi dhe eksporti i tyre, etj si dhe çdo aktivitet tjetër që direkt apo indirekt është i lidhur me realizimin e objektit të shoqërisë.

NENI 5 KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributi në të holla i Ortakëve themelues në vlerën 100,000 Lekë (njqind mijë) Lekë dhe është i përbërë nga dy kuota.

Kapitali themeltar ndahet si më poshtë:

- Zj. Eriona **Komino**, zotëron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50,000 Leke (pesëdhjetë mijë) Lekë dhe 50,000 Leke (pesëdhjetë mijë) Lekë të kapitalit themeltar.
- Z. Erion **Komino**, zotëron 1 kuotë, me 50% të kapitalit themeltar, me 1 (një) pjesë me vlerë 50,000 Leke (pesëdhjetë mijë) Lekë dhe 50,000 Leke (pesëdhjetë mijë) Lekë të kapitalit themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra me shumicat e parashikuara në këtë statut.

NENI 6 ORGANET SHOQERISE

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organit administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori. Asambleja e Përgjithshme emëron një ose më shumë personë fizikë si administrator të shoqërisë.

Zj. Eriona **Komino**, lindur më 25.10.1978, në Tiranë, mbajtëse e dokumentit të identifikimit me nr. personal H86025041E, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, zgjidhet si Administratore për një periudhë prej 5(pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhje.

NENI 7 LEGJISLACIONI I APLIKUESHEM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Eriona Komino
[Signature]


[Signature]

NENI 8
DISPOZITAT FINALE

Ky Akt Themelim hartohet në 2(dy) kopje origjonale në gjuhën shqipe.
Përmbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë,
duke autorizuar Administratoren Zj.Eriona Komino për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme
për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

Eriona Komino


A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Eriona Komino', written over a horizontal dashed line.

ORTAKU THEMELUES

Erion Komino


A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'ERION KOMINO', written over a horizontal dashed line.